



## Ku po çalon Reforma në Administratën Publike?

Klajdi Tozaj

### Hyrje

Reforma e Administratës Publike (RAP) është një ndër shumë hapa që ka ndërmarrë qeveria e Shqipërisë në kuadër të procesit të integritimit në BE. Kjo reformë mbart një rëndësi thelbësore në përparimin e procesit të integritimit por dhe për vetë zhvillimin e një administratë me vlera dhe parime demokratike.

Kjo reformë ndikon direkt tek çdokush nga ne, si në rolin e një qytetari të thjeshtë, një sipërmarrësi, një gazetari apo dhe një nëpunësi të administratës publike, që nga marrja e një informacioni deri në mbrojtjen e të drejtave tona parësore legjitime.

Kanë kaluar dy vite që prej afatit të strategjisë ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike dhe ende ndodhemi larg përfundimit. Çfarë e pengoi përparimin e zbatimit të RAP gjatë viteve 2015-2022?

Rëndësia e këtij punimi qëndron në faktin e konstatimit të atyre çështjeve që vazhdojnë të jenë problematike në zbatimin e reformës, duke synuar përqëndrimin e një informacioni të gjerë në mënyrë efiçente dhe praktike.

### Konteksti i përgjithshëm

Reforma nisi në vitin 2009, kur hyri në fuqi Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, me në fokus përmirësimin e shërbimit civil. Vlen të theksohet që personat që punojnë në këto pozicione, kanë një përgjegjësi të shtuar në krahasim me punonjësit e tjerë të administratës, pasi duhen të kujdesen për aplikimin e të drejtave të qytetarëve dhe të parimeve të një administrate demokratike.

Gjatë viteve 2014-2015, Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike u rihartua në një frymë më gjithëpërfshirëse, duke përfshirë aspekte lidhur me kontrollin



mbi administratën, transparencën mbi proceset vendimmarrëse, politikëbërjen dhe cilësinë e legjislacionit, meritokracinë në punësim, organizimin dhe funksionimin e administratës publike. Reforma parashikohej të vepronte deri në vitin 2020 por zbatimi u shty deri në vitin 2022.

Arsyet pse gjendemi para këtij realiteti janë të shumta. Duke u bazuar në raportet e Komisionit Evropian mbi ecurinë e Shqipërisë në vitet 2020 dhe 2022, duket qartë që pjesa më e madhe e çështjeve të papërfunduara të reformës janë po të njëjta ndër vite. Këto përfshijnë politikëbërjen dhe ligjëbërjen e bazuar në të dhëna, mangësitë në konsultimin publik, çështjet e rekrutimit, ngritjes në detyrë dhe shkarkimit bazuar në merita, sistemin e shpërblimeve, të drejtën e qytetarëve për administrim të mirë dhe aspekta të tjera që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me administratën publike.

Në vijim, duke u përqendruar në disa aspekte konkrete të reformës që janë përcaktuar në Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2015-2020 dhe bazuar në të dhënat dytësore të nxjerra nga raportet e Komisionit Evropian gjatë viteve 2019 deri në 2021, do mund të vërejmë dallimin midis pritshmërive të vendosura në fillim dhe përparimit konkret që ka arritur reforma gjatë viteve 2015 - 2022.

## Politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit

Në aspektin e politikëbërjes, që në vitin 2015 qeveria u kujdes të ndërtojë një mekanizëm bazë, Sistemin e Planifikimit të Integruar, i cili do kishte rol kyç në vendosjen e orientimeve të strategjive si dhe të parandalonte hartimin e politikave për çështje të posaçme apo mbivendosjen e tyre. Gjithashtu kemi dhe ngritjen e Grupeve të Menaxhimit Strategjik në çdo ministri, me detyra për të shqyrtuar aspekte të strategjive që lidhen me buxhetin, fondet e donatorëve dhe fondet IPA (fondet e para-aderimit në BE) dhe ngritjen e Grupeve Ndërministrorë të Punës.

Në aspektin legjislativ, gjatë vitit 2014 është punuar për reformën legjislative dhe për konsolidimin e kapaciteteve të përfshira në procesin e harmonizimit të legjislacionit të



brendshëm me *acquis* të BE-së. Çështjet që parashikonte kjo reformë si sfiduese ishin konsolidimi i Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) dhe kapaciteteve të angazhuara në këtë sistem, ngritja e sistemeve të informacionit brenda SPI-së, dhe ngritja e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në hartimin e reformës dhe legjislacionit. Gjithashtu, përpjekje u nevojitën për konsolidimin e procesit të monitorimit të performancës për strategjitë sektoriale/ndërsektoriale, ngritjen e kapaciteteve të Grupeve të Menaxhimit Strategjik (GMS), koordinimin midis Grupeve Ndërmministrorë të Punës, rritjen e kapaciteteve për nëpunësit civilë dhe vlerësimin e impaktit të politikave.

Duke iu referuar raportit të Komisionit Evropian (KE) të vitit 2020 dhe vitit 2022, janë vënë re disa problematika. Këto përfshijnë ngritjen e pjeshme të bazës ligjore dhe të institucioneve në lidhje me reformën, ecurinë e pamjaftueshme në vendosjen në punë të sistemit informativ të SPI-së, mungesën e përditësimit të kuadrit ligjor në planifikimin afatmesëm të politikëbërjes, dhe mungesën e koherencës midis planit strategjik dhe buxhetit të akorduar. Raportet e Komisionit gjithashtu theksojnë mangësi lidhur me krijimin e një funksioni qendror të kontrollit për cilësinë e funksionimit, përmirësimin e kontrollit të brendshëm gjatë fazës së implementimit të politikave, rritjen e përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve në administratën e Ministrive të linjës dhe Kryeministrisë në grumbullimin e të dhënave, dhe përcaktimin më të mirë të planeve për bërjen e politikave dhe funksionet monitoruese.

## Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore

Krahas ligjit, është ndërtuar Sistemi Informatik i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) i cili do ndiqej me ndryshimet përkatëse në strukturat e pagave për punonjësit e shërbimit civil.

Raportet e KE-së të viteve 2020 dhe 2022 pohojnë se gjatë zbatimit janë vënë re shqetësime lidhur me trajnimin e pamjaftueshëm të nëpunësve, forcimin e kapaciteteve të Departamentit të Administratës Publike në udhëheqjen strategjike të reformës në



Institute  
for Democracy  
and Mediation



Hanns  
Seidel  
Stiftung

shërbimin civil, efikasitetin e Komisionerit për Shërbimin Civil, dhe depolitizimin e shërbimit civil.

## Rritja e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike, garantimi i të drejtave të qytetarëve dhe qasja në informacion

Për sigurimin e arritjes së qëllimeve të reformës, ishte planifikuar të miratoheshin ndryshimet e reja në ligjin për të drejtën e informimit dhe të hartohej programi institucional i transparencës. Këto procese monitorohen nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit si dhe përdorimi i mjeteve TIK, portali *e-albania* dhe faqet përkatëse të institucioneve, me qëllim rritjen e transparencës së veprimtarisë së administratës.

Por aktualisht ndodhemi para fakteve të pohuara nga raportet e Komisionit Evropian si mangësi në ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore në pjesën e krijimit të organeve vartëse, nevoja për forcimin e të drejtës së qytetarëve për administrim të mirë (duke u bazuar në implementimin e ulët të rekomandimeve të Avokatit të Popullit), mungesa e një mekanizmi monitorues dhe analizues të praktikave administrative dhe gjyqësore për të drejtën e kompensimit, dhe shqetësimet lidhur me mbylljen në një afat të shkurtër kohor të sporteveve në administrate dhe aftësitë digjitale të qytetarëve.

## Përfundime

Në përfundim, mund të shihet se ka hapësirë të konsiderueshme midis fazave të zbatimit të reformës. Sipas vlerësimeve të aktorëve kyç në procesin e integritetit të Shqipërisë në BE, mbetet ende punë në lidhje me ecurinë e reformës të administratës publike. Vlen të përmendet fakti që pjesa më e madhe e çështjeve të papërfunduara vazhdojnë të jenë të njëjta ndër vite dhe pse afatet e reformës kanë kaluar.